

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Video - Vrasja e Artan Myrtaj/ Rikthehet në vëmendje e shkuara e errët e 'Danes', bashkëpunëtorit të 44-vjeçarit
ADRESA	https://www.syri.net/kronike/917973/vrasja-e-artan-myrta-j-rikthehet-ne-vemendje-e-shkuar-a-e-erret-e-danes-bashkepunetorit-te-44-vjecarit/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 11:26:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 11:03:33 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d2773ec045b12dc768adaa05affaf0ecc4f11dafe1e00fab9f81c6343ef60e87
TEKSTI	172238dc780dbc2e8aff420e7cf869e08747889c03f4fe0ae19850e64131490c
PAMJA	f524c2482ba67428d721c27d3e26b22d753bb2c57708535c5699a67c33fb9969

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	80995b97d3b406b9bee06348a3455d27bd9c6b0e3ac37e30fde9b5be2d49f569
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	36d3812b75abb32c2d0a144e9d997c17b4f1cdc4fe45cb80665e1d5362027ce4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/80995b97d3b406b9bee06348a3455d27bd9c6b0e3ac37e30fde9b5be2d49f569>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ENVER ROBELLI

Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshtja e Tiranës

NDRIM KULLA

Rama dhe Vuçiç, dy vëllezërit
siamezë të dekadencës
demokratike evropiane

më të lexuarat



Bllokimi i pagave të gjyqtarëve/ SPAK
merr në pyetje përgjegjësen e Thesarit, ja
çfarë dimë deri tani



Kurbin/ Banesa iu shemb nga tërmeti,
qytetari: Ende pa një afat për strehimin



Kapet mbi 400 kilogramë drogë në
frigorifer, arrestohet i riu shqiptar



Përfshihet nga flakët një makinë në një
parkim nëntokësor në Fier



Suk, fshati që po zbrazet: Kafenetë pa
klientë, vendin e tyre e kanë zënë pulat



Shortohet seanca për Ergys Agasin e
Uljan Shpatarakun- Ja kush gjyqtar e ka
në dorë



Falsifikuan dokumentet në 6 prona.

Vrasja e Artan Myrtaj/ Rikthehet në vëmendje e shkuara e errët e 'Danes', bashkëpunëtorit të 44-vjeçarit

13:03, 20/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Vrasja e 44-vjeçarit Artan Myrtaj, i cili u eliminua mëngjesin e sotëm në një lokal pranë kryqëzimit të ish-agjencisë në Sarandë, ka kthyer në vëmendje të shkuarën e errët dhe bashkëpunimin e tij me Ramadan Zoton, i njohur si "Dane", i cili korrikun e vitit të shkuar plagosi me armë zjarri dy të rinjtë nga Kamza.

Më 17 korrik të 2025, "Dane" plagosi me pistoletë Gëzim Hajdarajn, 33 vjeç, dhe Ernest Lamën, 25 vjeç, të dy nga Kamza, pas një konflikti të mbartur.

Brenda ditës së ngjarjes, rreth 50 forca policore nga Tirana, Vlora e Saranda prej orësh zhvilluan operacione për arrestimin e 43-vjeçarit të shumëkërkuar, Ramadan Zoto, alias Ramadan Canaj, i cili hapi zjarr 4 herë, duke i lënë të plagosur në një rrugë kryesore të lagjes nr. 4 në Sarandë.

Në momentin e ngjarjes mësohet se dhe Gëzim Hajdaraj ishte i armatosur, por ai nuk arriti të kundërpërgjigjej, ndërsa, për shkak të gjendjes së rënduar pas plumbave të marra, dy të rinjtë nga Kamza u nisën në gjendje të rëndë me helikopter nga lagja numër 4 e Sarandës, aty ku ndodhi ngjarja, në drejtim të Tiranës.

Bashkë me Zoton, korrikun e 2025, policia u vendos në kërkim dhe të 3 personave të tjerë për "përkrahje të autorit të kimit".

Njëri prej tyre është dhe vëllai i "Danes", Erjon Canaj, 36 vjeç, dhe dy shokët Artan Murtaj, 43 vjeç, dhe Klaus Jaçaj, 31 vjeç, të cilët rezultojnë me precedentë të ndryshëm penalë.

Pas plagosjes së dy të rinjve, në Sarandë nisi një sagë hakmarrjeje.

Në fillim të muajit tetor të 2025, u vra me tritol babai i Klaus Jaçajt, Isuf Jaçaj, ngjarje e cila ndodhi pak para mesnatës.

Automjeti tip fuoristradë ku ndodhej Isuf Jaçaj u përfshi nga një shpërthim i fortë që i mori jetën atij në vend.

Pas tritolit të vendosur ndaj Isuf Jaçajt, raportohet se në shënjestër ishin dhe prona të Ramadan Zotos, të cilat u hodhën në erë.

Në lidhje me plagosjen e Hajdarajt dhe Lames, Ramadan Zoto përfundoi prapa hekurave, ndërsa Artan Myrtaj dhe Klaus Jaçaj, të cilët u akuzuan për "përkrahje të autorit të krimit", fituan lirinë brenda pak kohësh. Asokohe, në kërkim të policisë vendase ishte Erjon Canaj, vëllai i "Danes".

Plagosja e të rinjve nga Kamza në lagjen numër 4 të Sarandës, në korrikun e 2025, nuk u përmbyll vetëm me arrestime dhe përballje me drejtësinë.

Të afërm të Gëzim Hajdarajt dhe Ernest Lames janë përbetuar që do të marrin hak për gjakun e tyre, të cilët prej më shumë se një viti po vijojnë me hakmarjen.

Pas vrasjes së babait të Klaus Jaçajt, Isufit, ngjarje e ndodhur në tetorin e 2025, sot iu mor jeta Artan Myrtajt, i cili përkrahu "Danen" pasi plagosi dy të rinjtë.

4 plumbat të cilët prekën para një viti Gëzim Hajdarajn dhe Ernest Lamën, sot e kësaj dite po i kushtojnë jetën personave që tentuan të mbanin ngjarjen e fshehtë.

Pista kryesore e hetimit dhe të gjitha dyshimet e vrasjes së Artan Myrtajt, i cili dha frymën e fundit para syve të nënës së tij, çojnë në ngjarjen e vitit 2025, ku u plagosën dy të rinjtë nga Kamza, miq të Ervis Lamit, një personazh i njohur i botës së krimit në Shqipëri.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Pamje ekskluzive/ VIDEO nga ajri i vrasjes 76 m larg policisë, oficerët mbidhnin gëzhojat në vendngjarje



EMRI/ Aksident në rrugën Fier-Seman, plagoset 27-vjeçarja



Atentati në Sarandë/ Kalimtar 73-vjeçar nisat me helikopter drejt Traumës në Tiranë

arrestohet ish-drejtori i ASHK në Fier, sekuestrohen 715 mijë euro



Shtyhet seanca ndaj Ilir Metës dhe Monika Kryemadhit, mungoi anëtari i trupit gjykues



Vdekja e bashkëshortes së Alban Hoxhës pas lindjes, Gjykata e Lartë rrezon rekursin e dy mjekëve

TË NGJASHME



Morinë/ Kapet 34-vjeçari nga Kosova, kërkohej nga autoritetet gjermane



Grupet kriminale lajnë hesapet 100 metra larg policisë - Vritet Artan Myrtaj, plagoset kalimtar



Del FOTO e Artan Myrtaj që iu bë atentat në qendër të Sarandës, plagoset edhe një kalimtar



Sarandë/ EMRI - Vrasje me armë në qendër, një i vdekur dhe një i plagosur



Gjirokastër/ Kapen me 100 steka cigare dhe 22 mijë euro, arrestohen dy 43-vjeçarë



Fier/ Në burg ish-drejtori i Kadastrës dhe përfituesi i pronës, detyrim paraqitjeje për topografin



Mbi 414 kg hashash në frigoriferë e valixhe, arrestohet 29-vjeçari shqiptar në Itali! Vlera në treg 4 mln euro

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net